




PRESIDENTJA OSMANI THOTË SE URGJENTISHT DUHET TË KONSTITUOHET KUVENDI

FAQE 4-5



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, u ka bërë thirrje partive parlamentare ta gjejnë një zgjidhje në përputhje me Kushtetutën e vendit për t'i themeluar Kuvendin dhe Qeverinë e re sa më

parë që jetë e mundur. "Që Kuvendi të konstituohet urgjentisht, që qeveria të zgjidhet po ashtu urgjentisht, çdo ditë e humbur është ditë e humbur për Kosovën, për popullin e saj, për

perspektivën tonë euroatlantike, kështu që shpresoj që të gjendet një zgjidhje në përputhje me Kushtetutën sa më parë që të jetë e mundur", ka thënë Osmani të premten për gazetarë

AKTUALE



**NË ZYRËN E IVICA DAÇIQIT
MBËRRIN NJË ZARF ME TRE
PLUMBA** F. 2

**NGA 31 GUSHTI DERI MË 5 SHTATOR
FSK-ja DO TË REALIZOJË USHTRIMIN
FUSHORË "UJKU SHIGJETË"** F. 3

**A ËSHTË LEGJITIM SHORTI PËR
NËNKRYETARIN SERB TË KUVENDIT?** F. 5

EKONOMI



**AVOKATI I POPULLIT: 80% E
PRONAVE NË KOSOVË JANË NË
EMËR TË BURRAVE, BARAZIA
GJINORE MBETET ENDE SFIDË** F. 8

**MURATI PJESË E FORUMIT MBI
NDIKIMIN EKONOMIK TË TARIFËS
DOGANORE 0% PËR PRODUKTET
AMERIKANE** F. 8

SPORT



**FODA PUBLIKON LISTËN
E FUTBOLLISTËVE PËR
NDESHJET E SHTATORIT** F. 10

**KURTI MBRON
BASHËN:
KAPITULLI QË
KA SHKRUAR
NUK KA TË BËJË
ASGJË ME UÇK-në** F. 7



**OVLUÇK-ja
U SHKRUAN
LETËR ZYRTARE
DEPUTETËVE,
KËRKON TË INICIOHET
PROCEDURA E
SHKARKIMIT TË
DIMAL BASHËS** F. 3



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princsha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...


Në zyrën e Ivica Daçiqit mbërrin një zarf me tre plumba

Beograd, 29 gusht - Në Qeverinë e Serbisë ka mbërritur një zarf i adresuar për ministrin e Brendshëm, Ivica Daçiq, brenda të cilit janë gjetur tre plumba, njoftoi më 29

gusht Ministria e Punëve të Brendshme serbe. Sipas njoftimit, zarfi është vërejtur të enjten “gjatë procesit të rregullt të ndarjes së postës”. “Gjatë kontrollit të

sigurisë me pajisje me rreze X, në zarf u gjetën tre plumba”, thuhet në komunikatën e Ministrisë së Brendshme serbe. Autoritetet shtuan se policia ka identifikuar dhe gjetur

personin që më 26 gusht kishte dorëzuar dërgesën në një degë të Postës së Serbisë në Pozharevc. Nuk është bërë i ditur identiteti i të dyshuarit.



Ushtria izraelite thotë se Qyteti i Gazës tani “është zonë e rrezikshme lufte”

GAZA, 29 GUSHT - Ushtria izraelite e shpalli Qytetin e Gazës “zonë të rrezikshme lufte” më 29 gusht, para ofensivës së paralajmëruar për marrjen e kontrollit të plotë të qytetit më të madh në territorin palestinez pas pothuajse dy vjet lufte.

Izraeli po përballë me presion të madh nga brenda dhe jashtë vendit për t'i dhënë fund ofensivës në Gazë, ku Kombet e Bashkuara kanë shpallur zi të bukës.

Ushtria izraelite, megjithatë, po përgatitet që të zgjerojë luftimet dhe të marrë kontrollin e Qytetit të Gazës, me një zëdhënës të ushtrisë që tha: “Nuk po presim”. “Kemi nisur operacionet fillestare dhe fazat fillestare të sulmit ndaj Qytetit të Gazës dhe ne aktualisht jemi duke operuar me forcë të madhe në periferi të qytetit”, shkroi në X zëdhënësi i ushtrisë izraelite, Avichay Adraee.

Sipas vlerësimeve të OKB-së, pothuajse gjysmë milion banorë aktualisht jetojnë në Qytetin e Gazës me rrethinë.

Në njoftimin e ushtrisë izraelite të lëshuar të premten u tha se nga tani, Qyteti i Gazës “konsiderohet zonë e rrezikshme lufte” dhe se pauzat ditore të aktivitetit ushtarak, që kanë për synim lehtësimin e shpërndarjes së ndihmave, më nuk do të aplikohen në këtë zonë.

Ushtria nuk i bëri thirrje popullsisë që të largohet menjëherë, por Adraee ka thënë më herët gjatë kësaj jave se evakuimi i qytetit “është i pashmangshëm”.

Grupet për të drejtat e njeriut që gjenden në Gazë kanë paralajmëruar kundër zgjerimit të fushatës ushtarake.

Javën e kaluar, ministri izraelit i Mbrojtjes, Israel Katz, u zotua se Qyteti i Gazës do të shkatërrohet



nëse Hamasi - grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - nuk pajtohet që t'i japë fund luftës, sipas kushteve të Izraelit.

Ai ka miratuar planet e ushtrisë për marrjen nën kontroll të qytetit dhe ka autorizuar thirrjen e pothuajse 60.000 rezervistëve. Zëdhënësi Adraee tha të

premtën se ushtria do të intensifikojë sulmet derisa të gjitha pengjet e mbetura në Gazë të lirohen dhe Hamasi të shkatërrohet.

Lufta në Gazë nisi pasi Hamasi sulmoi jugun e Izraelit më 7 tetor 2023, duke vrarë afër 1.200 persona dhe duke rrëmbyer 251 të tjerë. Nga 251 pengjet, 47 ende po mbahen në Gazë dhe afër 20 prej tyre beohet se janë ende gjallë.

Mes paralajmërimeve për ofensivën në Qytetin e Gazës, agjencia për mbrojtje civile në Gazë raportoi se 33 palestinezë u vranë nga forcat izraelite në mbarë territorin më 29 gusht.

Që nga nisja e luftës në Gazë, si pasojë e ofensivës izraelite janë vrarë më shumë se 62.000 palestinezë, sipas shifrave të publikuara nga Ministria e Shëndetësisë në këtë territor - që OKB-ja i vlerëson si shifra të besueshme.

Britania s'i lejon zyrtarët izraelitë të marrin pjesë në panairin më të madh të mbrojtjes

LONDËR, 29 GUSHT - Britania e Madhe ua ka ndaluar pjesëmarrjen zyrtarëve izraelitë në panairin e saj më të madh tregtar të mbrojtjes, për shkak të përshkallëzimit të luftës kundër Hamasit në Gazë, në përpjekje për të ushtruar tryzni ndaj aleatit historikisht të ngushtë për shkak të konfliktit. Qeveria e kryeministrit Keir Starmer tha në korrik se do ta njihje shtetin palestinez, nëse Izraeli nuk do të ndërmerre hapa për t'i lehtësuar vuajtjet e palestinezëve në Gazë dhe nëse nuk do të përmbushte kushte të tjera, duke e zemëruar Qeverinë izraelite.



Ministria e Mbrojtjes e Izraelit tha se, si pasojë e këtij ndalimi, nuk do ta organizojë pavijonin e saj kombëtar si më parë në

panairin Defence & Security Equipment International (DSEI), në Londër. Megjithatë, kompanitë izraelite

të mbrojtjes, si Elbit Systems, Rafael, IAI dhe Uvision, do të mundë të marrin pjesë.

Një zëdhënës i Qeverisë britanike tha të premten se vendimi i Qeverisë izraelite për ta përshkallëzuar më shumë luftën në Gazë ishte i gabuar. “Si pasojë, ne konfirmojmë se asnjë delegacion qeveritar izraelit nuk do të ftohet të marrë pjesë në DSEI UK 2025”, tha ai. “Duhet të ketë zgjidhje diplomatike për ta përfunduar këtë luftë tani, me armëpushim të menjëhershëm, kthimin e pengjeve dhe një rritje të ndihmës humanitare për popullin e Gazës”, shtoi ai.

Izraeli e cilësoi vendimin e Britanisë si “akt të pafat diskriminimi” dhe se “po fut konsiderata politike krejtësisht të papërshtatshme për një ekspozitë profesionale të industrisë së mbrojtjes”.

Panairi katërditor, i cili hapet më 9 shtator, mbledh delegacione shtetërore dhe kompani private që ekspozojnë pajisje dhe armë ushtarake në qendrën Excel të Londrës. Ky aktivitet zhvillohet çdo dy vjet. DSEI organizohet nga një kompani private, Clarion Defence and Security, por me mbështetjen e Qeverisë dhe ushtrisë britanike.

Fuqitë evropiane aktivizojnë mekanizmin për rivendosjen e sanksioneve ndaj Iranit

LONDËR, 29 GUSHT - Britania, Franca dhe Gjermania kanë aktivizuar një mekanizëm për rivendosjen automatike të sanksioneve të Kombeve të Bashkuara, që parashihen në marrëveshjen bërthamore të

Iranit të vitit 2015.

Tri fuqitë evropiane, të njohura edhe si E3, i kanë shkruar Këshillit të Sigurimit të OKB-së më 28 gusht për nisjen e procesit, i cili merr 30 ditë kohë.

Përmes një njoftimi, ministrat e

Jashtëm të E3-shit, thanë se “ne do të përdorim periudhën 30-ditore për të vazhduar angazhimin me Iranin sa i përket ofertës sonë për zgjatje apo çdo përpjekje të rëndësishme diplomatike në rikthimin e

Tehranit në përmbushjen e zotimeve”.

Ata theksuan se “ndajmë objektivin themelor që Irani nuk duhet kurrë të kërkojë, zotërojë ose zhvillojë një armë bërthamore”.



OVLUÇK-ja U SHKRUAN LETËR ZYRTARE DEPUTETËVE, KËRKON TË INICIOHET PROCEDURA E SHKARKIMIT TË DIMAL BASHËS

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 GUSHT- Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i ka shkruar letër zyrtare deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe shefave të grupeve parlamentare, përmes së cilës kërkuan të iniciohet procedura për shkarkimin e Dimal Bashës, nga pozita e kryetarit të Kuvendit të Kosovës. OVLUÇK-ja në këtë letër ka shprehur siç thonë “shqetësimin dhe indignatën e thellë për publikimin e hulumtimeve dhe shkrimeve të bashkautoruara nga kryetari aktual i Kuvendit të Kosovës, Dimal Basha, ku Ushtria Çlirimtare e Kosovës është përshkruar në mënyrë denigruese si ‘milici e nëntokës e lidhur me banda kriminale dhe droge’”. “Ky qëndrim përbën një fyerje të rëndë për luftën tonë çlirimtare, për sakrificën e dëshmorëve dhe martirëve të kombit, si dhe për vetë themelet mbi të cilat është ngritur shteti i Kosovës. Një individ që ka mohuar dhe njollosur luftën e UÇK-së nuk gëzon më legjitimitet moral e politik për të përfaqësuar institucionin më të lartë përfaqësues të qytetarëve tanë”, thuhet në letër. OVLUÇK-ja u ka bërë thirrje



shefave të grupeve parlamentare që të marrin përgjegjësinë politike dhe institucionale për iniciimin e procedurës së shkarkimit të Dimal Bashës nga posti i kryetarit të Kuvendit si dhe të veprojnë me urgjencë,

duke mos lejuar që Kuvendi i Republikës së Kosovës të drejtohet nga një person me qëndrime të tilla fyese ndaj UÇK-së dhe historisë sonë të lavdishme. “OVLUÇK thekson se kjo kërkesë nuk është thjesht një

qëndrim politik, por një obligim ndaj së vërtetës historike dhe sakrificës së popullit të Kosovës për liri. Deputetët e Kuvendit, të zgjedhur nga qytetarët, kanë për detyrë të mbrojnë këtë vlerë dhe të

garantojnë që në krye të institucionit më të lartë demokratik të vendit të mos qëndrojnë dikush që e ka njollosur luftën çlirimtare”, thuhet në letrën e kësaj organizate.

KURTI MBRON BASHËN: KAPITULLI QË KA SHKRUAR NUK KA TË BËJË ASGJË ME UÇK-në



PRISHTINË, 29 GUSHT - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, i ka dalë të premten në mbrojtje kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Dimal Basha, për artikullin kundër UÇK-së. Kurti ka thënë se Dimal Basha e ka dhënë sqarimin për atë publikim, duke theksuar se kapitulli që ka shkruar ai nuk ka asgjë të bëjë me UÇK-në. Ai ka thënë se problemi që kemi sot në Kosovë nuk e kemi nga një deformim dhe keqinterpretim i një artikulli me bashkautorësi, por sipas tij, ato janë më të mëdha; si nënshkrimi Zajednicës në 2013-n, amnistimi i kriminelëve serbë në veri,

votimi i Gjykatës Speciale... “Kryetari i Kuvendit Dimal Basha e ka dhënë sqarimin për atë publikim që është bërë para se më shumë se një dekadë dhe aty e ka sqaruar se kapitulli apo kreu që ka shkruar ai nuk ka asgjë të bëjë me UÇK-në. Ju e keni parë edhe fjalimin e tij pas zgjedhjes, ku ka shprehur vlerësimet me të larta për këtë vlerë të shenjtë të kombit shqiptar. Besoj se problemi që kemi sot në Kosovë nuk e kemi nga një deformim dhe keqinterpretim i një artikulli me bashkautorësi, ku ky nuk është autor i atij kapitulli të para më shumë se të një dekadë.

Problemet i kemi kur është nënshkruar Zajednica në 2013-n, problemet i kemi kur janë amnistuar kriminelët serbë në veri po ashtu në 2013-n, problemet i kemi kur është votuar Gjykata Speciale në 2015-n, problemet i kemi kur është themeluar Lista Serbe në bashkëpunim me Beogradin në vitin 2013, problemet i kemi kur politikanët e Kosovës kanë bërë qeveri duke u varur nga Lista Serbe, problemet i kemi kur kanë hyrë në pazare për ndarje të Kosovës, e jo të ky farë artikulli ku manipulohet me një kapitull, në të cilin ky fare nuk ka autorësi”, ka thënë Kurti.

Nga 31 gushti deri më 5 shtator FSK-ja do të realizojë ushtrimin fushorë “Ujku Shigjetë”

PRISHTINË, 29 GUSHT - Nga data 31 gusht deri më 5 shtator 2025, Forca e Sigurisë së Kosovës do të realizojë ushtrimin fushorë “Ujku Shigjetë”, në kuadër të

përgatitjeve për validimin e Regjimentit të tretë. Gjatë kësaj periudhe do ketë lëvizje të konvojeve nga vendbazimet e Forcës së

Sigurisë së Kosovës në drejtim të rajonit të Gjakovës, saktësisht Aeroportit të Gjakovës dhe Poligonit ushtarak në Babaj të Bokës. “E

gjithë kjo lëvizje do të bëhet me qëllim të realizimit të ushtrimit, andaj kërkojmë mirëkuptim nga qytetarët”, ka njoftuar FSK-ja.





PRESIDENTJA OSMANI THOTË SE URGJENTISHT DUHET TË KONSTITUOHET KUVENDI

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, u ka bërë thirrje partive parlamentare ta gjejnë një zgjidhje në përputhje me Kushtetutën e vendit për t'i themeluar Kuvendin dhe Qeverinë e re sa më parë që jetë e mundur. “Që Kuvendi të konstituohet urgjentisht, që qeveria të zgjidhet po ashtu urgjentisht, çdo ditë e humbur është ditë e humbur për Kosovën, për popullin e saj, për perspektivën tonë euroatlantike, kështu që shpresoj që të gjendet një zgjidhje në përputhje me Kushtetutën sa më parë që të jetë e mundur”, ka thënë Osmani të premten për gazetarë

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 29 GUSHT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, u ka bërë thirrje partive parlamentare ta gjejnë një zgjidhje në përputhje me Kushtetutën e vendit për t'i themeluar Kuvendin dhe Qeverinë e re sa më parë që jetë e mundur.

Thirrja e Osmanit vjen në një kohë kur Kuvendi ka mbetur peng i zgjidhjes së nënkryetarit të vet nga pakica serbe - hapi i fundit i nevojshëm për konstituimin e Kuvendit përfundimisht.

Këtë javë u duk sikur Kosova do të bëhej me Kuvend të ri më në fund pas një ngërçi të gjatë pas zgjedhjeve të shkurtit, sepse zgjodhi kryetarin dhe katër nënkryetarët.

Megjithatë, partitë parlamentare kanë hasur sërish në mospajtime

për votimin e nënkryetarit nga pakica serbe në Kuvend. “Që Kuvendi të konstituohet urgjentisht, që qeveria të zgjidhet po ashtu urgjentisht, çdo ditë e humbur është ditë e humbur për Kosovën, për popullin e saj, për perspektivën tonë euroatlantike, kështu që shpresoj që të gjendet një zgjidhje në përputhje me

Kushtetutën sa më parë që të jetë e mundur”, tha Osmani.

Një ditë më parë, deputetët nuk e votuan asnjë nga kandidatët e Listës Serbe të hedhur në votim përmes shortit për nënkryetar të Kuvendit.

Vota nuk mori as deputeti tjetër serb, Nenad Rashiq nga Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, i cili nuk përkrahet nga Lista Serbe.

Rashiq, i cili nuk ishte votuar as në seancën e kaluar i mori 56 vota për, 1 kundër, ndërsa 20 deputetë abstenuan.

Deputetët do të mbledhen sërish të shtunën për ta vazhduar seancën konstituive aty ku ka mbetur të enjten.

Votimi ndaras për nënkryetarët nga pakicat ka nxitur dyshime se mund të jetë shkelur Kushtetuta e vendit, pasi në të kaluarën ata janë votuar në një pako.

Osmani tha se “nuk dua ta jap

interpretime kushtetuese për këtë situatë”, kur u pyet për votimin ndaras nga gazetarët pasi bëri homazhe te Monumenti i Personave të Zhdukur në Prishtinë, në shënim të Ditës Ndërkombëtare të të Zhdukurve me Dhunë.

Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka thënë të premten se shpreson që të shtunën do të zgjidhet edhe nënkryetari i Kuvendit të Kosovës nga komunitetet serbe. “Ka ngelur edhe një nënkryetar që të zgjidhet, besoj së më së miri do të ishte që të kryhet kjo punë nesër, duke e përzgjedhur Nenad Rashiqin, i cili e pranon Republikën e Kosovës, punon për institucionet e shtetit tonë dhe njëkohësisht është ministri i cili ka bërë më së shumti për komunitetin serb në vendin tonë”, ka thënë sot Kurti në një deklaram për gazetarë.

Eugen Cakolli nga KDI-ja ka thënë se po bëhet gjithnjë e më e qartë se vendi po shtyhet me vetëdije drejt një krize të re kushtetuese, edhe më të thellë se ajo për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit. “Me konsumimin procedural të të gjitha kandidataturave të mundshme nga radhët e komunitetit serb - sado që vetë procedura e ndjekur nuk është në harmoni me aktgjykimet e Kushtetueses - pas seancës së ardhshme, Kuvendi mund të mos ketë më as për çka të mbledhet, pasi nuk do të ketë më asnjë kandidat që mund të propozohet. E gjithë kjo situatë, si rezultat i devijimeve procedurale dhe shkeljes së aktgjykimave të Gjykatës Kushtetuese nga kryetari i Kuvendit, do të përfundojë ose si rast i ri në Kushtetuese, ose eventualisht me zgjedhje të reja pas skadimit të afatit 30-ditor, varësisht prej përfundimit të shqyrtimit të kërkesës së dërguar nga presidentja”, ka thënë ai.

Cakolli ka theksuar se nëse do të kemi inicim të një rasti të ri kushtetues, përveç humbjes së disa javëve apo muajve, skenari më i mirë do të ishte anulimi dhe rikthimi i procedurës në pikën zero, duke u kthyer te praktika e votimit të nënkryetarëve të komuniteteve në pako. “Por në rastin më të keq të mundshëm, rrezikohet një precedent që kodifikon një lloj shumice të dyfishtë për propozimin dhe

Osmani diskuton me Prattipatin për ‘hapat drejt konstituimit të plotë’ të Kuvendit

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka diskutuar me të ngarkuarën me punë në Ambasadën amerikane në Kosovë, Anu Prattipati, për hapat drejt përmbylljes së procesit të konstituimit të Kuvendit të Kosovës.

Seanca konstituive për

legjislaturën e dalë nga zgjedhjet e shkurtit ka nisur më 15 prill, por edhe nuk është përmbyllur. “Gjatë takimit u diskutua për zhvillimet e fundit në vend, përfshirë zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit dhe shumicës së nënkryetarëve, si dhe hapat e mëtejshëm drejt konstituimit të

plotë të Kuvendit”, u tha në njoftimin e lëshuar nga Presidenca e Kosovës.

Në të kaluarën, Prattipati ka thënë se ngërçi politik po i shkakton humbje të mundësive për Kosovën, ndërkaq Osmani e ka vlerësuar si “urgjencë shtetërore” konstituimin e Kuvendit.

A ËSHTË LEGJITIM SHORTI PËR NËNKRYETARIN SERB TË KUVENDIT?

Konstituimi i Kuvendit të Kosovës tani ka mbetur peng i votimit për nënkryetarin serb. Pasi Lista Serbe refuzoi ta ndryshonte kandidatin, kur i propozuari i saj dështoi tri herë t'i merrte votat e nevojshme, kryekuvendari vendosi që emri i ri të përcaktohej me short. Në këtë proces u përfshi edhe Nenad Rashiq, nga një tjetër parti serbe. Juristët theksojnë se këto zhvillime bien ndesh me Kushtetutën. Çfarë tani?

PRISHTINË, 29 GUSHT - Pas zgjedhjes së kryetarit dhe tre nënkryetarëve nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, Kuvendit të Kosovës i mbeti edhe detyra për t'i zgjedhur dy nënkryetarë nga komunitetet joshumicë: një nga pakicat joserbe, dhe një nga minoriteti serb.

Ndryshe nga vitet e kaluara, kur për këta dy nënkryetarë votohej në pako, këtë vit votimi është ndarë. Juristët vlerësojnë se një gjë e tillë është kundërkushtetuese, por se për ta konfirmuar këtë dikush duhet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese.

Përfaqësuesja e komuniteteve të tjera joserbe, Emilija Rexhepi, u zgjodh nënkryetare e Kuvendit. Por, procesi ngeci kur erdhi puna te zgjedhja e nënkryetarit nga komuniteti serb. Lista Serbe, e cila në Kuvend ka 9 nga 10 vendet e rezervuara për serbët, këmbënguli ta propozonte Sllavko Simiqin. Megjithatë, ai nuk arriti të siguronte 61 votat e nevojshme as pas tri rundeve të votimit.

Pasi Lista Serbe nuk pranoi të propozonte dikë tjetër për nënkryetar, kryetari i Kuvendit, Dimal Basha, vendosi të hidhte short, sipas Rregullores së punës së Kuvendit, për të nxjerrë një emër tjetër nga komuniteti serb.

Çfarë thotë Kushtetuta dhe Rregullorja për nënkryetarin serb?

Përveç disa deputetëve të tjerë të Listës Serbe, për këtë post u propozua edhe Nenad Rashiq nga partia serbe Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, aktualisht ministër në detyrë në qeverinë e Albin Kurtit. As Rashiq nuk i mori votat e nevojshme, ndërkohë që juristët



vënë në dyshim edhe kushtetutshmërinë e një zgjedhjeje të mundshme të tij. Pse? Sepse Rregullorja parasheh që “kandidati për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e komunitetit serb propozohet nga shumica e deputetëve të komunitetit serb”. Ndërkaq, Kushtetuta e Kosovës thotë se nënkryetari “do të jetë nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara të komunitetit serb”. Rashiq tha për “Radion Evropa e Lirë” se një zgjedhje eventuale e tij nuk do të ishte kundërkushtetuese, dhe se, në këtë rast, ai i referohet asaj që shkruan në Kushtetutë, e jo në Rregulloren e Kuvendit. Kryekuvendari Basha, duke u thirrur në një aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese, tha se secili

kandidat i propozuar mund të hidhet në votim më së shumti tri herë.

Meqë asnjëri prej kandidatëve nuk arriti të zgjidhej më 26 gusht, procesi u vazhdua dy ditë më vonë. Por, situata mbeti e njëjtë: askush nuk i mori 61 votat e nevojshme më 28 gusht. Lëvizja Vetëvendosje e mbështeti vetëm Rashiqin, por votat e saj nuk mjaftuan.

Seanca u ndërpre, për të vazhduar më 30 gusht. Rashiq ka edhe një shans tjetër, pasi dy deri tani janë shfrytëzuar.

Megjithatë, ekspertët thonë se i gjithë ky proces është jokushtetues.

Ehat Miftaraj, nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, deklaroi për “Radion Evropa e Lirë” se në bazë të Kushtetutës, praktikës së

drejtësisë kushtetuese dhe praktikës parlamentare, në parim mënyra e votimit të nënkryetarëve bëhet në bazë të propozimit me shkrim të një kandidati që ka shumicën e votave të deputetëve të komunitetit serb në Kuvendin e Kosovës. Sipas tij, kjo procedurë anashkalohet vetëm nëse nuk vjen fare propozimi nga përfaqësuesit në Kuvend. “Andaj, shorti dhe votimi është duke u bërë në kundërshtim me Kushtetutë dhe me Rregulloren. Çdo vendim që vjen si rezultat i kësaj forme është kundërkushtetues. Fatkeqësisht, edhe kjo fazë e ngërçit politik, siç duket, duhet të zgjidhet nga Gjykata Kushtetuese, në mungesë të vullnetit politik për të zbatuar Kushtetutën dhe praktikën parlamentare”, tha Miftaraj.

Ai shtoi se kandidatura e Rashiqit

është në kundërshtim të plotë me Kushtetutën, praktikën gjyqësore, praktikën parlamentare dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit, pasi i njëjti nuk ka shumicën ose gjashtë nënshkrime nga deputetët e komunitetit serb. “Në aspektin juridik, tërë këto votime janë të pavlefshme dhe s’kanë asnjë vlerë kushtetuese apo juridike”.

Çfarë nëse diskualifikohen të gjithë deputetët serbë?

Duket se votimi me short do të vazhdojë, por çfarë ndodh nëse, për shkak të mungesës së votave, pasi secili të ketë dështuar nga tri herë, diskualifikohen të gjithë deputetët serbë? “Nëse asnjë kandidat nuk merr 61 vota, atëherë vijmë në një situatë të re, që nënkupton se Kuvendi ka dështuar të konstituohet. Nuk ka dispozitë që lejon votimin e ri nga fillimi për të njëjtët kandidatë”, tha Miftaraj. Lista Serbe tashmë ka paralajmëruar se do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me ankesë. Eugen Cakolli, nga Instituti Demokratik i Kosovës, tha se “po bëhet gjithnjë e më e qartë se vendi po shtyhet me vetëdije drejt një krize të re kushtetuese, edhe më të thellë se ajo për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit”. “Me konsumimin procedural të të gjitha kandidaturave të mundshme nga radhët e komunitetit serb - sado që vetë procedura e ndjekur nuk është në harmoni me aktgjykimet e Kushtetueses - pas seancës së ardhshme, Kuvendi mund të mos ketë më as përçka të mblidhet, pasi nuk do të ketë më asnjë kandidat që mund të propozohet”. Mbetet të shihet se çfarë do të prodhojë vazhdimi i seancës së të shtunës.

Operacioni policor “Lugu”, vihen në pranga gjashtë persona të dyshuar

PRISHTINË, 29 GUSHT - Policia e Kosovës, respektivisht Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë në Prishtinë të asistuar edhe nga organe tjera të sigurisë, pas hetimeve intensive të zhvilluara ndaj gjashtë të dyshuarve meshkuj kosovarë nën dyshimet se të njëjtit janë marrë me shit-blerje të substancave narkotike në

rajonin e Prishtinës ka realizuar operacionin policor “Lugu”. “Me datën 06.08.2025 rreth orës 12:00 nën autorizimin e Prokurorisë Themelore dhe me urdhëresë të Gjykatës në Prishtinë, është zbatuar plani operativ ku janë zhvilluar kontrolle në tetë lokacione (shtëpi, banesa dhe objekte përcjellëse), ku me urdhër të prokurorit është



mbyllur edhe një lokal (free shop). Operacioni është mbështetur edhe nga Njësia Speciale Operative, Drejtoria e Teknikës Kriminalistike, njësia

K9 si dhe njësitë patrulluese nga rajoni i Prishtinës. Si rezultat i këtij plani operativ janë arrestuar gjashtë persona të dyshuar si dhe në cilësinë e provave materiale janë gjetur dhe sekuestruar: 1. 300 gramë substancë e dyshuar narkotike e llojit kokainë (vlëra e së cilës vlerësohet se është rreth 18 000 euro), 2. 13. 294 euro, 3. 2 DVR, 4. 5 vetura me targa vendore si

dhe prova tjera materiale që ndërlidhen me rastin. Të dyshuarit janë shoqëruar për intervistim në prezencë të avokatëve mbrojtës dhe me vendim të prokurorit të shtetit janë ndaluar për 48 orë. Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar në parandalimin dhe luftimin e shpërndarjes së narkotikëve”, ka njoftuar Policia e Kosovës.

zgjedhjen e nënkryetarëve nga radhët e komuniteteve - skenar që duhet shmangur me çdo kusht”, ka thënë Cakolli.

Kryetari i partisë së dytë më të madhe në Kuvendin e Kosovës, PDK, Memli Krasniqi, e ka akuzuar partinë fituese të zgjedhjeve, Lëvizja Vetëvendosje,

se “dëshiron” ta vazhdojë ngërçin politik.

Duke folur pas dështimit të radhës për ta konstituuar Kuvendin, Krasniqi tha për gazetarë: “Ju po e vëreni që ka një tentim për të mos shkuar tutje me konstituimin e Kuvendit, por çfarë më befason mua është fakti

se si krejt Vetëvendosja, nga Kurti deri te deputeti i fundit, po angazhohen për ta bërë nënkryetar një deputet të komunitetit serb, që, nëse e krahasoj, shumë më pak janë angazhuar për Albulena Haxhiun apo Dimal Bashën”.

Krasniqi shpjegoi se deputetët e

partisë së tij po abstenojnë nga votimi për Rashiqin, “sepse mënyra e votimit është jokushtetuese”. “Ajo çfarë e ka karakterizuar sjelljen e Vetëvendosjes nga 15 prilli është veprimi jokushtetues dhe këtë e ka dëshmuar dy herë Gjykata Kushtetuese”, tha Krasniqi.

Sipas tij, ndikimi politik dhe real i ngërçit është “fakti që po vazhdon bllokada e nuk po konstituohet Kuvendi dhe rrjedhimisht nuk po arrijmë ta fusim në afate kushtetuese Albin Kurtin për ta dëshmuar atë që e kemi thënë gjithë: ai nuk i ka votat për ta formuar qeverinë”.

Krerët e shtetit: Të vërtetës dhe drejtësisë për të pagjeturit nuk mund t'i shmanget askush

PRISHTINË, 29 GUSHT - Në prag të Ditës Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur, presidentja Vjosa Osmani, kryeministri në detyrë Albin Kurti dhe kryetari i Kuvendit, Dimal Basha, bënë homazhe pranë monumentit kushtuar personave të zhdukur me dhunë gjatë luftës në Kosovë dhe nën okupimin e Serbisë. Duke nderuar kujtimin e 1584 qytetarëve ende të zhdukur, kryeministri kujtoi se shteti i Kosovës po punon me përkushtim maksimal për këtë çështje, përmes

gërmimeve dhe hetimeve të vazhdueshme. Gjatë vitit të kaluar janë realizuar kërkime në 23 lokacione, ndërsa sivjet janë zhvilluar 18 aktivitete për gjetjen e mbetjeve mortore të viktimave, të cilat, siç tha Kryeministri, “u vranë nga Serbia, u zhvarrosën dhe iu rrëmbyen edhe kufomat”. Kryeministri Kurti shprehu shqetësimin për mungesën e progresit në gërmimet në territorin e Serbisë, veçanërisht në lokacionet Kozhle dhe Batajnicë,

pavarësisht marrëveshjeve dhe deklaratave të dakorduara që nga viti 2023. “Mohimi i drejtësisë ndaj viktimave tona të luftës së fundit, në fakt paraprihet nga mohimi i krimeve të kryera nga Serbia, që e bën Beogradin zyrtar”, theksoi Kryeministri. Ai falënderoi partnerët ndërkombëtarë për mbështetjen dhe kërkoi trysni më të madhe ndaj Beogradit, ku ndodhen të dhënat dhe përgjegjësit për zhdukjet me dhunë.



I PAMPOSHTURI

Ismail SYLA

Mbrëmje e paharrueshme në shtëpinë e veprimtarit të përkushtuar të çështjes kombëtare, z. Gani Koci, i cili me optimizëm të çeliktë po e mund një sëmundje të rëndë, duke i ndenjur përballë me fuqinë morale, kujdesin maksimal shëndetësor dhe me përkrahjen e pareshur të familjes së tij të ngushtë, vajzave dhe djalit, Ulpianit si dhe bashkudhëtarës së tij besnike, zonjës Sanije. Gani Koci është ndër organizatorët më të rëndësishëm të demonstratave në konviktet e Qendrës së Studentëve më 26 mars 1981. I burgosur dhe i dënuar, ai qëndroi burrërisht në burgjet jugosllave, duke u bërë model qëndrese dhe kryeneçësie kudo që e shpunë në burgje. Pas daljes nga burgu, Gani Koci ishte ndër emrat më të njohur të ish të burgosurve politikë. I angazhuar në formacionin politik masiv, siç qe në atë kohë Lidhja Demokratike e Kosovës, ai dhe kontribut të shquar, por gjithmonë e ruajti boshtin e tij politik dhe vertikaltetin edhe në kohë ndryshimesh të rëndësishme në Kosovën e okupuar rëndë nga regjimi serb. Kur u sos sokaku i veprimit politik, Gani Koci hoqi kapelën partiake dhe vuri atë ushtarake që në daljen publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. La komoditetin e jetës “urbane” në Prishtinë dhe kaloi në UÇK në Zonën e Drenicës deri në



përfundim të luftës. Fillimisht la në Prishtinë gruan me vajza, për t'i sjellë më vonë në terrene lufte përgjatë gjithë periudhës së luftës 1998/99. Detyrën e çlirimtarit e kreu me përgjegjësi dhe ndërgjegje të lartë. Pas luftës bëri jetë pa pretendime maksimaliste, por natyrshëm kreu obligime dhe detyra që iu besuan, si në Kuvendin e Kosovës, si në pozita të merituar qeveritare. Në Partinë Demokratike të Kosovës qe zë autentik, i drejtë,

transparent dhe aspak i kamufluar me mantelin e oportunizmit. Në të gjitha debatet e Këshillit Drejtues, Gani Koci që zë i guximshëm, i vetvetes, transparent dhe kurrë profil ambiguitiv. Përgjatë karrierës normale politike kurrë nuk e fshehu pezmin atëherë kur gjërat nuk ecnin si duhet, por asnjëherë nuk e shqelmoi formacionin politik për teke egoiste, ambicie individuale, duke tejkaluar grackën e shpirtngushtësisë dhe

kurthin e lakmisë. I pensionuar sipas ligjit të moshës, Gani Koci po bënte jetë të qetë, pot një ditë botërisht e shpalosi faktin se po vuante nga sëmundja e trishtë e kancerit në mëllçi. Ky lajm qe një bombë në veshët e miqve. Me marrjen e terapisë, me kujdesin rigoroz Gani Koci po e mund sëmundjen. Si duket çdo ditë e më shumë shenjat e stopimit të saj po bëhen të dukshme. Gjatë kësaj mbrëmjeje na ra të

kujtojmë kapituj të ndryshëm jetësor, të ndriçojmë elemente biografike edhe më shumë, si rezultat i ndejës së gjatë. Ganiu është shumë i kthjelltë, i vëmendshëm, i gjallë dhe energjik. Ky vitalitet bëri që në vend të ndejës një orëshe, të zgjatet biseda deri pas mesnate. Kjo bisedë ka në vetvete misterin e saj. Nuk është bisedë e MALLIT TË JETËS. Jo, është bisedë e normalitetit të jetës. Bisedën e “mallit të jetës” e kisha përjetuar me mikun tim të shtrenjtë Beqir Hajrizin nga Bradashi i Podujevës. Sëmundja në mushkëri e kishte vënë në shtratin e mallit të jetës. Nostalgjia e ndërthurur me fije testamentesh, fjali të urta sintetizuese që zbërthejnë kuptimin e jetës... e plot ripërtypje segmentesh nga jeta e kaluar... shfaqeshin dhjetë vjet më parë, kur e vizitua Beqir Hajrizin, së bashku me mikun e përbashkët, Fadil Uka... E mbrëmë, biseda e gjallë me Gani Kocin, normalitetit, koncentrimi dhe rrjedha dinamike e saj tregojnë se Ganiu, pavarësisht të gjithave, nuk ka kohë për të lejuar rrjedhjen e rrymave të dëshpërimit... Në fund, me një dozë të shtuar vullneti vjen momenti kur duhet t'i them natën e mirë, dhe të përshëndetemi pa frikë dhe nostalgji, përkundrazi, me një grusht kokrra kumbullash dhe një qese me kokrra domatinash të rritura në kopshtin e oborrit të tij, më uron natë të mirë. E, ç'të them tjetër, pos “Rrofsh sa malet o Gani Koci!”

Fushë-Kosovë, përurohet çerdhja e re për 60 fëmijë dhe vihet gurthemeli për shkollën e re

Fushë-Kosovë, 29 gusht-Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, së bashku me ministren në detyrë të Arsimit, Arbërie Nagavci, dhe kandidatin e LV-së për kryetar të Fushë-Kosovës, Valon Prebreza, morën pjesë në përuarimin e çerdhës së re për 60 fëmijë dhe në vënien e gurthemelit për shkollën e re në Fushë-Kosovë, dy investime të Ministrisë së Arsimit,

Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Çerdhja moderne ka një sipërfaqe prej 750 m² dhe kushton rreth 415 mijë euro, duke ofruar kushte të përshtatshme për kujdesin dhe zhvillimin e fëmijëve. Kryeministri Kurti njoftoi se gjatë këtij mandati, në arsimin e Fushë-Kosovës janë investuar mbi 5.6 milionë euro, duke theksuar

rëndësinë e investimeve në edukimin e hershëm si themel për të ardhmen e vendit. Pas përuarimit të çerdhës, kryeministri vijoi me vendosjen e gurthemelit për Shkollën Filllore dhe të Mesme të Ulët në të njëjtën komunë, një investim prej 3.8 milionë euro për një hapësirë prej 8,000 m², me kapacitet për 1,500 nxënës.



KROACIA DËRGON NË PARABURGIM DY TË ARRESTUARIT PËR SPIUNAZH, KOSOVA E GATSHME TË BASHKËPUNOJË

PRISHTINË, 29 GUSHT - Kroacia ka shqiptuar masën e paraburgimit ndaj dy të dyshuarve për spiunazh për Serbinë, teksa autoritetet në Kosovë thanë se janë të gatshme të bashkëpunojnë për këtë rast, pasi “veprimtaria e të arrestuarve është zhvilluar në Kosovë”.

Ndërkaq, nga KFOR-i thanë se i trajtojnë “me seriozitet” pretendimet se pjesëtari kroat i misionit - që u arrestua në Krocia - ka zbuluar informacione të ndjeshme.

Prokuroria e Qarkut në Split njoftoi më 28 gusht se pas pranimit të kallëzimit penal nga Sektori i Pavarur për çështje të policisë ushtarake një ditë me herët, ka ndërmarrë veprimet e para hetimore dhe ka nxjerrë vendim për fillimin e hetimeve kundër një shtetasi të Republikës së Kroacisë (i lindur më 1971) për veprën penale të spiunazhit, dhe kundër një shtetaseje të Republikës së Serbisë (e lindur më 1979) për të njëjtën vepër penale.

Po ashtu, “me vendim të Prokurorisë së Qarkut në Split është caktuar fshehtësia e tërë e hetimit, me arsyetimin se publikimi i të dhënave nga procedura mund të dëmtojë zhvillimin e hetimeve”.

Sipas medias kroate, Index, piloti

korat J.I. dhe e dashura e tij, A.M. serbe nga Mitrovica e Veriut dyshohen se kanë spiunuar për Serbinë. Është raportuar se ajo kishte punuar në Misionin e Bashkimit Evropian në Kosovë për Sundim të Ligjit, EULEX.

Sipas Index-it, që u thirr në burime, dyshohet se piloti kroat, i angazhuar në misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, i ka dhënë informacione konfidenciale partneres së tij, të cilat ajo më pas ua ka përcjellë anëtarëve të Listës Serbe.

Lista Serbe është partia kryesore e serbëve në Kosovë, që gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar. Prokuroria e Qarkut në Split i ka propozuar gjyqtarit të hetimeve të Gjykatës së Qarkut në Split caktimin e paraburgimit për të pandehurin e parë, për shkak të rrezikut të ndikimit mbi dëshmitarët dhe të përsëritjes së veprës penale, ndërsa për të pandehurën e dytë për shkak të rrezikut të arratisjes, ndikimit mbi dëshmitarët dhe përsëritjes së veprës penale. “Gjyqtari i hetimeve e ka pranuar pjesërisht kërkesën e prokurorisë dhe ka caktuar paraburgim për të pandehurin e parë për shkak të rrezikut të ndikimit mbi dëshmitarët, si dhe për të pandehurën e dytë për shkak të rrezikut të arratisjes dhe ndikimit



mbi dëshmitarët”, thuhet në njoftimin e Prokurorisë së Qarkut në Split. “Megjithatë, për të dy të pandehurit është refuzuar propozimi për paraburgim lidhur me rrezikun e përsëritjes së veprës penale. Prokuroria e Qarkut në Split ka njoftuar se do të parashtrojë ankesë kundër pjesës së vendimit me të cilën është refuzuar kërkesa e saj”. Nga misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, KFOR, thanë se i “marrin me seriozitet” pretendimet se piloti kroat ka zbuluar tek e dashura e tij

informacione për lëvizjet e serbëve në veri, si dhe të pjesëtarëve të këtij misioni. “Ne i marrim shumë seriozisht këto pretendime. Siguria e personelit të KFOR-it dhe integriteti i informacionit të klasifikuar janë parësore”, tha një zyrtar i NATO-s për Radion Evropa e Lirë. Zëdhënësi i Qeverisë në detyrë të Kosovës, Përparim Kryeziu, tha se “duke qenë se veprimtaria e A.M. dhe shtetasit kroat, të dy të arrestuar në Kroaci, është zhvilluar në Kosovë, institucionet tona janë në gatishmëri të plotë

që të bashkëpunojnë me institucionet e Kroacisë për zhvillimin e mëtejme të hetimeve dhe zbardhjen e plotë të aktiviteve dhe rrjetit të veprimit”.

Ndërkaq, deputeti i Listës Serbe, Igor Simiq, pas seancës së Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 28 gusht, u pyet nga gazetarët lidhur me këtë rast. Ai u përgjigj shkurt se as ai dhe as ndonjë eksponent tjetër i Listës Serbe nuk e njeh A.M., duke mohuar që ndokush prej tyre të ketë pasur lidhje me të. /Rel.

KROACIA DËRGON NË PARABURGIM DY TË ARRESTUARIT PËR SPIUNAZH, KOSOVA E GATSHME TË BASHKËPUNOJË

PRISHTINË, 29 GUSHT - Kroacia ka shqiptuar masën e paraburgimit ndaj dy të dyshuarve për spiunazh për Serbinë, teksa autoritetet në Kosovë thanë se janë të gatshme të bashkëpunojnë për këtë rast, pasi “veprimtaria e të arrestuarve është zhvilluar në Kosovë”.

Ndërkaq, nga KFOR-i thanë se i trajtojnë “me seriozitet” pretendimet se pjesëtari kroat i misionit - që u arrestua në Krocia - ka zbuluar informacione të ndjeshme.

Prokuroria e Qarkut në Split njoftoi më 28 gusht se pas pranimit të kallëzimit penal nga Sektori i Pavarur për çështje të policisë ushtarake një ditë me herët, ka ndërmarrë veprimet e para hetimore dhe ka nxjerrë vendim për fillimin e hetimeve kundër një shtetasi të Republikës së Kroacisë (i lindur më 1971) për veprën penale të spiunazhit, dhe kundër një shtetaseje të Republikës së Serbisë (e lindur më 1979) për të njëjtën vepër penale.

Po ashtu, “me vendim të Prokurorisë së Qarkut në Split është caktuar fshehtësia e tërë e hetimit, me arsyetimin se publikimi i të dhënave nga procedura mund të dëmtojë zhvillimin e hetimeve”.

Sipas medias kroate, Index, piloti



korat J.I. dhe e dashura e tij, A.M. serbe nga Mitrovica e Veriut dyshohen se kanë spiunuar për Serbinë. Është raportuar se ajo kishte punuar në Misionin e Bashkimit Evropian në Kosovë për Sundim të Ligjit, EULEX.

Sipas Index-it, që u thirr në burime, dyshohet se piloti kroat, i angazhuar në misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, i ka dhënë informacione konfidenciale partneres së tij, të cilat ajo më pas ua ka përcjellë anëtarëve të Listës Serbe.

Lista Serbe është partia kryesore e

serbëve në Kosovë, që gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar. Prokuroria e Qarkut në Split i ka propozuar gjyqtarit të hetimeve të Gjykatës së Qarkut në Split caktimin e paraburgimit për të pandehurin e parë, për shkak të rrezikut të ndikimit mbi dëshmitarët dhe të përsëritjes së veprës penale, ndërsa për të pandehurën e dytë për shkak të rrezikut të arratisjes, ndikimit mbi dëshmitarët dhe përsëritjes së veprës penale. “Gjyqtari i hetimeve e ka pranuar pjesërisht kërkesën e prokurorisë dhe ka caktuar

paraburgim për të pandehurin e parë për shkak të rrezikut të ndikimit mbi dëshmitarët, si dhe për të pandehurën e dytë për shkak të rrezikut të arratisjes dhe ndikimit mbi dëshmitarët”, thuhet në njoftimin e Prokurorisë së Qarkut në Split. “Megjithatë, për të dy të pandehurit është refuzuar propozimi për paraburgim lidhur me rrezikun e përsëritjes së veprës penale. Prokuroria e Qarkut në Split ka njoftuar se do të parashtrojë ankesë kundër pjesës së vendimit me të cilën është refuzuar kërkesa e saj”.

Nga misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, KFOR, thanë se i “marrin me seriozitet” pretendimet se piloti kroat ka zbuluar tek e dashura e tij informacione për lëvizjet e serbëve në veri, si dhe të pjesëtarëve të këtij misioni. “Ne i marrim shumë seriozisht këto pretendime. Siguria e personelit të KFOR-it dhe integriteti i informacionit të klasifikuar janë parësore”, tha një zyrtar i NATO-s për Radion Evropa e Lirë.

Zëdhënësi i Qeverisë në detyrë të Kosovës, Përparim Kryeziu, tha se “duke qenë se veprimtaria e A.M. dhe shtetasit kroat, të dy të arrestuar në Kroaci, është zhvilluar në Kosovë, institucionet tona janë në gatishmëri të plotë që të bashkëpunojnë me institucionet e Kroacisë për zhvillimin e mëtejme të hetimeve dhe zbardhjen e plotë të aktiviteve dhe rrjetit të veprimit”.

Ndërkaq, deputeti i Listës Serbe, Igor Simiq, pas seancës së Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 28 gusht, u pyet nga gazetarët lidhur me këtë rast. Ai u përgjigj shkurt se as ai dhe as ndonjë eksponent tjetër i Listës Serbe nuk e njeh A.M., duke mohuar që ndokush prej tyre të ketë pasur lidhje me të. /Rel.

OEK-u thotë se Gjykata Supreme do ta shqyrtojë padinë e tyre kundër ZRrE-së për tregun e lirë të energjisë

PRISHTINË, 29 GUSHT - Oda Ekonomike e Kosovës njofton se Gjykata Supreme ka vendosur që padia e ushtruar nga OEK-u ndaj Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE), lidhur me daljen e detyrueshme në tregun e lirë të energjisë, do të procedohet dhe do të shqyrtohet për vendim meritot.

Në njoftim thuhet se tashmë

është caktuar kolegji i gjyqtarëve i cili do ta trajtojë padinë ndaj ZRrE. “Përkundër që kërkesa për vendosjen e masës së përkohshme për pezullimin e vendimit nuk është aprovuar, me arsyetimin se akti “Njoftimi i ZRrE-së” nuk i plotëson kriteret e një akti nënligjor normativ, çështja do të shqyrtohet në mënyrë meritore për të gjitha

aktet nënligjore të ZRrE-së, përveç këtij njoftimi, sipas afateve ligjore. Andaj, pritjet e Odës Ekonomike të Kosovës janë që gjykata të vendosë brenda afatit 60 ditor nga dita e parashtrimit të padisë, siç e parasheh ligji dhe të anulojë të gjitha aktet nënligjore të ZRrE-së me të cilat janë përcaktuar kriteret për daljen në tregun e

lirë”, thuhet në njoftim. Më tej, theksohet se “Pavarësisht se masa e përkohshme e sigurisë nuk është aprovuar, Oda Ekonomike e Kosovës vlerëson pozitivisht faktin se lënda do të trajtohet në themel dhe shpreh besimin se vendimi final do të jetë në të mirë të ekonomisë, bizneseve dhe qytetarëve të Kosovës”.



PËRURORHET PIKA GRUMBULLUESE PËR PEMËT E IMËTA NË KOMUNËN E GJILANIT

GJILAN, 29 GUSHT - Është bërë inaugurimi i pikës së re grumbulluese për pemë të imëta në Shtanishor nga Komuna e Gjilanit, mbështetur nga TIKa Turke, me iniciativën e Shoqatës “Mjedra e Kosovës”.

Kjo pikë ofron mundësi për fermerët e Anamoravës e më gjerë që të ruajnë prodhimet e tyre.

Në ceremoni ishin kryetari i Komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ambasadori i Turqisë në Kosovë Sabri Tunç Angili, koordinatori e TIKa në Kosovë, Fulya Aslan, nënkryetari i Komunës së Artanës, Bajrush Ymeri, drejtori për Bujqësi Bajram Isufi, fermerë dhe zyrtarë të tjerë.

Kryetari i Komunës së Gjilanit,

Alban Hyseni, tha se kishte kënaqësinë të pret në takim ambasadorin e Turqisë në Kosovë, Sabri Tunç Angili. “Temë kryesore ishte ndërtimi i pikës së grumbullimit për pemë të imta, projekt i përbashkët i TIKa-s dhe Komunës së Gjilanit, me kapacitet vjetor prej 150 tonësh produkt”, tha Alban Hyseni.

I pari i komunës theksoi se ky investim vjen pas subvencionimit nga komuna të 7 hektarëve të mbjellë: 5 hektarë me mjedra (19 përfitues) dhe 2 hektarë me boronica (10 përfitues).

Kryetari Hyseni tha se me një vlerë prej 118 mijë euro, përfituesit janë mbështetur me fidanë, vazo, gjeotekstil, sistem ujitjeje me pompë dhe pajisje

për spërkatje. “Ky është një hap i rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë, rritjen e prodhimit vendor dhe krijimin e mundësive të reja për fermerët tanë”, tha i pari i Gjilanit.

Ambasadori i Turqisë në Kosovë, Sabri Tunç Angili, tha se investimet sikur kjo e pikës grumbulluese për pemë të imëta janë shumë të rëndësishme.

Ai falënderoi Agjencinë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA) për hapjen e kësaj pike grumbulluese në kuadër të projektit “Instalimi i pikës grumbulluese për prodhuesit e pemëve të imëta në komunën e Gjilanit”.

Ambasadori Angili, falënderoi edhe kryetarin e Komunës së Gjilanit, Alban Hysenin për



bashkëpunimin shkëlqyeshëm.

Sipas tij ky projekt ka për qëllim të lehtësojë procesin e grumbullimit të prodhimeve bujqësore dhe të përkrahë

drejtpërdrejt prodhuesit lokalë të pemëve të imëta, duke ndikuar pozitivisht në zhvillimin ekonomik të rajonit dhe fuqizimin e sektorit bujqësor në Gjilan.

AVOKATI I POPULLIT: 80% E PRONAVE NË KOSOVË JANË NË EMËR TË BURRAVE, BARAZIA GJINORE MBETET ENDE SFIDË

PRISHTINË, 29 GUSHT - Në episodin e radhës të podcastit për të drejtat pronësore në Telegrafi, me redaktoren Jehona Hulaj, i ftuar ishte Avokati i Popullit, Naim Qelaj, i cili foli për sfidat që lidhen me të drejtat pronësore në Kosovë, duke nisur nga padrejtësitë historike e deri te zvarritjet burokratike e gjyqësore që pengojnë qytetarët në realizimin e të drejtave të tyre themelore.

Qelaj theksoi se Kosova ende nuk e ka përfunduar procesin e



rikthimit të pronave dhe shtoi se të gjitha vendet e rajonit e kanë kryer këtë proces, përveç Kosovës.

Ai paralajmëroi se së shpejti do të dalë me një raport të hollësishëm për këtë çështje, si pjesë e hetimeve të nisura nga institucioni që ai drejton.

Sipas tij, privatizimi i tokave pa adresuar të drejtën e pronarëve të mëparshëm ka sjellë pasojë të mëdha. “Thuaja që të gjitha fondet e tokave janë privatizuar pa u kryer procesi i kompensimit

apo kthimit. Kjo barrë tash bie mbi buxhetin e shtetit”, tha Qelaj, duke e cilësuar këtë si padrejtësi të thellë historike që duhet të adresohet me urgjencë.

Ai shtoi se një tjetër problem i madh është informaliteti në pronësi. “Një numër i madh i pronave janë ende të regjistruara në emër të personave të vdekur, apo të familjarëve që nuk janë pronarë të vërtetë, duke sjellë paqartësi dhe konflikte të shumta gjyqësore”, u shpreh Avokati i Popullit.

Në lidhje me barazinë gjinore në pronësi, Qelaj tha se sot vetëm rreth 20 për qind e pronave janë të regjistruara në emër të grave, ndërsa 80 për qind në emër të burrave, edhe pse ligji garanton barazi.

Ai shtoi se “si shoqëri vazhdojmë të jemi pak patriarkale në këtë aspekt”, dhe vuri në pah ndikimin e normave zakonore në këto praktika: “Ndikimi që kanë këto norma zakonore shpeshherë është aq i fuqishëm sa ndoshta ia kalon edhe ligjit”.

Murati pjesë e forumit mbi ndikimin ekonomik të tarifës doganore 0% për produktet amerikane

PRISHTINË, 29 GUSHT - Ministri në detyrë i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati ishte pjesë e forumit të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane lidhur me vendimin për heqjen e tarifave doganore për produktet nga ShBA.

Në fjalën e tij, Murati vlerësoi se ky vendim forcon partneritetin strategjik mes Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës si dhe krijon kushte më të favorshme

për investime të reja, duke e bërë Kosovën më tërheqëse për investitorët amerikanë dhe ndërkombëtarë.

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Agron Llugaliu, theksoi se Dogana ka filluar me kohë zbatimin e vendimit dhe se përvoja nga marrëveshjet e mëparshme tregtare dëshmon qartë se liberalizimi i tregut sjell rezultate të prekshme, si rritje të eksporteve dhe përfitime për konsumatorët.

Në emër të Ambasadës së

ShBA-së, e ngarkuara me punë, Anu Prattipati, e përshëndeti vendimin si një hap të rëndësishëm për zgjerimin e tregtisë dhe investimeve, duke theksuar se qasja më e lehtë në mallra cilësore amerikane do të sjellë përfitime si për konsumatorët, ashtu edhe për bizneset kosovare.

Qeveria e Kosovës mbetet e përkushtuar të zbatojë politika që forcojnë bashkëpunimin ekonomik ndërkombëtar.



KUR FRIKA U PËRHAP SI NJË VIRUS: MISTERI I “GRANDE PEUR” NË REVOLUCIONIN FRANCEZ



Verë, korrik i vitit 1789. Në Francë, vetëm pak javë pasi ishte rrëzuar kulla e Bastijës, një tjetër stuhi nisi të frynte – jo nga topat, por nga fjalët. Një panik i pakontrolluar, i quajtur “Grande Peur” – Frika e Madhe, u përhap në fshatra e qytete me shpejtësinë e një sëmundjeje ngjitëse. Njerëzit dëgjonin fjalë për banda të armatosura, për komplotet e aristokratëve që donin të shtypnin revolucionin, dhe brenda natës çdo zë i panjohur bëhej i frikshëm, çdo kalorës i huaj dukej si kërcënim. Po çfarë ishte në të vërtetë kjo “epidemi” e panikut? Dhe si mund të shpjegohet sot, me shumë se dy shekuj më vonë?

Një epidemi pa mikrobe

Një ekip studiuesish nga Universiteti Shtetëror i Milanos, në bashkëpunim me universitetet e Parisit dhe

Tulonës, vendosën të analizojnë këtë fenomen me sy modern. Ata përdorën modele epidemiologjike – zakonisht të përdorura për përhapjen e viruseve – për të parë se si frika kishte ecur nga një fshat në tjetrin. Rezultati ishte befasues: paniku udhëtonte mesatarisht 45 kilometra në ditë, kulmin e pati më 30 korrik 1789, dhe shpesh kalonte aty ku kishte stacione postare, nyjet e komunikimit të kohës. Ashtu si sot një “fake news” shpërndahet nëpër rrjetet sociale, atëherë ishin rrugët, karrocet e postës dhe fjalët nëpër tregje ato që e shpërndanë frikën.

Fshatrat më të pasur, më të arsimuar – më të goditurit

Një tjetër gjetje e papritur:

“Grande Peur” nuk u përhap thjesht aty ku njerëzit ishin më të ndjeshëm emocionalisht. Jo. Ishte më e fortë pikërisht në zonat më të pasura dhe më të alfabetizuara, atje ku informacioni qarkullonte më shpejt. Dhe një faktor tjetër ishte thelbësor: çmimi i grurit. Me bukën që kushtonte gjithnjë e më shumë dhe me ligjet feudale që rëndonin mbi fshatarët, frika nuk ishte vetëm fantazi – ishte një reagim i dëshpëruar ndaj një realiteti të padurueshëm.

Nga frika tek revolucionin

Paniku nuk mbeti vetëm thashethem. Ai i dha zjarr kryengritjeve: fshatarët sulmuuan pronarët, dogjën dokumentet e detyrimeve feudale, dhe ushqyen revoltën që çoi më pas në një vendim historik. Më 4 gusht 1789, Asambleja Kombëtare hoqi

privilegjet feudale, duke i dhënë fund një epoke shekullore. Kështu, një valë zërash dhe frikash u kthye në një moment kyç politik, që ndryshoi rrjedhën e Revolucionit Francez.


Një mësim për kohën tonë

Profesori Stefano Zapperi nga Universiteti i Milanos, një nga autorët e studimit, e shpjegon thjeshtë: “Grande Peur është një shembull i fuqisë që kanë zërat dhe informacioni në ndryshimet politike. Atëherë ishin rrugët dhe stacionet e postës, sot janë rrjetet sociale. Logjika është e njëjtë: një fjalë mund të ndizte zjarrin e revoltës.” Studimi, i botuar në Nature, na kujton se historia nuk është thjesht e shkuar: është një

pasqyrë e së tashmes. Ashtu si paniku i vitit 1789 u përhap si një virus, sot fake news apo teoritë konspirative ndjekin të njëjtat mekanizma, vetëm se me shpejtësi marramendëse dixhitale.

Përfundim: Fjalët që drodhën botën

“Grande Peur” ishte më shumë se thjesht një panik. Ishte prova se fjalët mund të jenë më të forta se armët, se një thashethem mund të lëkundë themelet e pushtetit, dhe se një krizë ekonomike mund të bëjë që një popull i tërë të shpërthejë. Dhe sot, kur lajmet e rreme shpërndahen me një klikim, ajo që përhapim mund të jetë po aq e rrezikshme dhe po aq vendimtare sa ngjarjet që shkruajnë historinë. / **bota.al**



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Jaylani Darden, basketbollist i ri i Vëllaznimit

Basketbollisti amerikan Jaylani Darden është përforsuar në skuadër të Vëllaznimit për sezonin 2025/26. Ekipi gjakovar, të enjten mbrëma ka prezantuar basketbollistin e gjatë 196 centimetra, që luan në pozitë 2 dhe 3, si dhe njihet për shpejtësinë, lojën në mbrojtje dhe saktësinë nga distanca. Darden te Vëllaznimi transferohet nga NCAA, saktësisht ekipi State Spartans, ku ka treguar paraqitje të mirra dhe ka luajtur me një mesatare prej 15 pikëve, 6 kërcimeve e 3 asistimeve për ndeshje. “Me ardhjen e tij, Darden pritët të sjellë energji dhe intensitet të lartë të punës në Gjakovë, duke qenë një element i rëndësishëm për objektivat e Vëllaznimit tonë në këtë sezon”, ka shkruar Vëllaznimi. Darden është i huaji i katërt te Vëllaznimi për sezonin e ri pas Ziggy Reid, Seth Pinkey e Jacob Young.

FODA PUBLIKON LISTËN E FUTBOLLISTËVE PËR NDESHJET E SHTATORIT



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 GUSHT - Franco Foda, përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, të premten ka publikuar listën zyrtare të futbollistëve të ftuar për dy ndeshjet e ardhshme kualifikuese për Kupën e Botës 2026, të cilat do të zhvillohen gjatë muajit shtator. “Dardanët” do të përballen fillimisht me Zvicrën më 5 shtator në qytetin e Baselit, në një sfidë shumë të rëndësishme dhe sfiduese për Kombëtaren, ndërsa tri ditë më pas, më 8 shtator, ata do të rikthehen në shtëpi për të pritur Suedinë në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë. Këto dy përballje janë të vlefshme për Grupin B të fazës kualifikuese për Kampionatin Botëror dhe konsiderohen vendimtare për vazhdimësinë e ëndrrës së Kosovës për të siguruar një vend në garën më prestigjioze të

futbollit botëror. Trajneri gjerman ka ftuar gjithsej 26 futbollistë, me qëllimin për të arritur rezultate pozitive dhe për të mbajtur gjallë shpresat për kualifikim. Në mesin e të ftuarve, bie në sy prania e dy emrave të rinj: Leon Avdullahu dhe Veldin Hodza, të cilët për herë të parë bashkohen me përfaqësuesen A, duke reflektuar strategjinë e Fodës për të freskuar ekipin me energji të reja dhe potencial afatgjatë. Megjithatë, në listë nuk mungojnë as emrat me përvojë dhe kontribut të madh për ekipin kombëtar, si Vedat Muriqi, Amir Rrahmani, Milot Rashica, Bernard Berisha, Edon Zhegrova, Florent Vojvoda dhe portieri Samir Ujkani. Përveç listës kryesore, Foda ka publikuar edhe listën e futbollistëve rezervë, të cilët mund të thirren në rast nevojë. Në këtë listë përfshihen: Faton Maloku, Leard Sadriu, Ron Raqi, Andi Hoti, Donat Rudhani, Kreshnik Hajrizi, Ismet Lushaku, Behar Neziri,

Kreshnik Krasniqi, Lirjon Abdullahu, Bledian Krasniqi dhe Rilind Nivokazi. Foda ka shprehur besimin e tij në potencialin e ekipit dhe ka theksuar rëndësinë e mbështetjes së tifozëve në këto dy ndeshje shumë të rëndësishme për të ardhmen e “Dardanëve” në skenën ndërkombëtare. Stërvitjen e parë Kosova do ta zhvillojë, të hënën, më 1 shtator, në orën 17:00 në Kampin Nacional në Hajvali. Paraprakisht, në orën 12:00, përzgjedhësi Franco Foda do të paraqitet në konferencë për media në hotel “Emerald”.

LISTA E FUTBOLLISTËVE

A.Muriq, A.Saipi, V.Bekaj, M.Vojvoda, F.Hadergjonaj, A.Rrahmani, L.Dellova, I.Krasniqi, F.Aliu, L.Paqarada, D.Gallapeni, E.Rexhbeçaj, V.Berisha, V.Hodza, L.Emërlahu, L.Avdullahu, E.Krasniqi, F.Haxha, M.Jashari, B.Zabërgja, M.Koreni, F.Muslija, A.Rrahmani, F.Aslani, V.Muriqi.

Shkurt

Juan Mesa operohet me sukses

Skuadra e Dritës nga Gjilani ka njoftuar se futbollisti Juan Mesa e ka kryer me sukses operimin. “Ju njoftojmë që lojtari ynë Juan Camilo Mesa ka kryer me sukses operimin. Mesa ishte i pafat dhe kishte këputur ligamentin ACL në stërvitje me ekipin ku po përgaditeshim për ndeshjen e raundit të tretë të Ligës së Evropës me FCSB. Mesas i dëshirojmë shërim të shpejtë”, thuhet në njoftimin e klubit gjilanas. Drita arriti sukses historik duke siguruar kualifikimin në fazën e grupeve të Ligës së Konferencës.

KB Ylli përforcohet me amerikanin Trevon Allen

Skuadra e Golden Eagle Yllit është përforcuar me amerikanin Trevon Allen. Skuadra suharekase po vazhdon me përforsime me faktin se ka synime të mëdha në vitin jubilar të klubit. “Trevon Allen i bashkohet Golden Eagle Yllit për sezonin 2025/2026, me misionin e vetëm që në vitin jubilar të 50-vjetorit të klubit, të rikthejë skuadrën te sukseset”, ka njoftuar KB Ylli.

Zhegrova ndryshon mendje, arrin marrëveshje me Marseillen

Reprezentuesi i Kosovës, Edon Zhegrova thuhet se ka arritur marrëveshje totale me Olympique Marseille për një kontratë pesëvjeçare. Gjërat po trazohen seriozisht për të ardhmen e Edon Zhegrovës. 26-vjeçar kosovar, i cili sapo ka marrë pasaportën shqiptare, ishte pranë një transferimi te Juventusi, i cili shihej si favorit për shërbimet e tij. Megjithatë, sipas Footmercato, numri 23 i Lille dhe Marseille kanë arritur një marrëveshje të plotë, me Zhegrovën që i ka dhënë përparësi gjigantit francez ndaj Juventusit. Marseille thuhet se tani duhet të arrijë një marrëveshje me Lille për të përfunduar transferimin. “U arrit marrëveshja e plotë midis Olympique Marseille dhe Edon Zhegrovës. Kontratë deri më qershor 2030. Zhegrova zgjodhi OM pavarësisht interesit nga Juventusi”, ka shkruar gazetari i njohur Santi Aouna në profilin e tij.

Drita dhe Shkëndija do të përballen në Ligën e Konferencës

GJILAN, 29 GUSHT - Drita dhe Shkëndija kanë mësuar kundërshtarët e tyre në fazën e ligës në Ligën e Konferencës. Shorti e ka vendosur kampionen e Kosovës, Dritën përballë disa rivalëve të njohur nga futbolli evropian.

Në grup me Dritën do të jenë: AZ Alkmaar nga Holanda, një skuadër me traditë të fortë në garat evropiane, Rayo Vallecano nga La Liga spanjolle, Omonia Nicosia nga Qipro, Kups Kuopio nga Finlanda, Shkëndija nga

Maqedonia e Veriut dhe Shelbourne nga Irlanda. Kjo fazë grupore pritët të jetë një sfidë e madhe për Dritën, e cila synon të përfaqësojë sa më denjësisht futbollin kosovar në arenën ndërkombëtare. Përballjet me

ekipe me eksperiencë evropiane si AZ Alkmaar dhe Rayo Vallecano do të jenë test i vërtetë për skuadrën gjilanasë, ndërsa duetlet me Shkëndijën, Omonian, Kupsin dhe Shelbourne pritët të jenë më të balancuara.



Fenerbahçe shkarkon Jose Mourinhon

STAMBOLL, 29 GUSHT - Jose Mourinho nuk është më trajneri i Fenerbahçes. Klubi turk njoftoi largimin e “Special One” vetëm dy ditë pas humbjes ndaj Benficas në ndeshjen “play-off” të Ligës së Kampionëve, rezultat që vulosi mungesën e skuadrës në fazën e grupeve për të dytin vit

radhazi. Portugezi, i cili mori drejtimin e klubit në qershor të vitit 2024, nuk arriti të fitonte asnjë trofe. Në Superligën turke, Fenerbahçe u rendit në vendin e dytë, 11 pikë pas rivalëve të Galatasarayt. Në Evropa Ligë 2024/2025, skuadra e tij u eliminua në fazën e 1/8-ave nga

Rangers, ndërsa në Kupën e Turqisë ndaloi në çerekfinale. “Ne jemi ndarë me Jose Mourinho, trajnerin e ekipit tonë të parë për sezonin 2024-2025. E falënderojmë për përkushtimin ndaj skuadrës dhe i urojmë suksese në të ardhmen”, ka njoftuar klubi turk. Ky është

shkarkimi i tretë radhazi për Mourinhon pas aventurave me Manchester United (2018), Tottenham (2021) dhe Romën (2024). Gjatë periudhës së tij në Stamboll, ai drejtoi Fenerbahçen në 62 ndeshje, duke regjistruar 37 fitore, 14 barazime dhe 11 humbje. Sipas të përditshmes



Fanatik, Mourinho do të përfitojë një dëmshpërblim prej 15 milionë eurosh pas ndërprerjes së kontratës.

Sylvinho: Nuk është momenti për eksperimente, sfidë shumë e rëndësishme ndaj Letonisë

TIRANË, 29 GUSHT - Trajneri i Kombëtares Shqiptare, Sylvinho, ka bërë publike listën me 25 lojtarë të grumbulluar për dy sfidat e muajit shtator: miqësoren kundër Gjibraltarit dhe ndeshjen vendimtare ndaj Letonisë, e vlefshme për kualifikueset e Botërorit 2026. Tekniku brazilian ka zgjedhur të mos sjellë emra të rinj këtë herë, duke i besuar grupit aktual të lojtarëve që kanë qenë pjesë e skuadrës edhe në ndeshjet e fundit. “Kemi bërë rreth 50% të rrugëtimit dhe kemi edhe katër ndeshje për të luajtur. Jemi duke luftuar kundër kohës dhe duhet të përgatitemi mirë, sidomos për sfidën me Letoninë në shtëpi. Për lojtarët që mungojnë, si Ismajli, kam folur personalisht. Ka një dëmtim të lehtë dhe preferuam të mos rrezikojmë”, ka thënë Sylvinho në konferencën për shtyp. Trajneri u shpreh se nuk është momenti për eksperimente, por miqësorja ndaj Gjibraltarit do të shërbejë për të testuar disa elementë. “Nuk është koha për ndryshime të mëdha. Kur një lojtar nuk ka më çfarë të japë, atëherë bëhen ndryshime, por aktualisht të gjithë lojtarët janë të motivuar. Gjibraltari do të na japë mundësinë të provojmë disa lojtarë si Bajrami, Berisha dhe Pajaziti, që ende nuk



kanë luajtur 45 minuta me Kombëtaren. Ndeshja me Letoninë është e fortë, e dimë që është një sfidë vendimtare dhe kërkon përgatitje maksimale”, ka shtuar ai. Në lidhje me situatën e lojtarëve si Nedim Bajrami dhe Ernest Muçi, Sylvinho konfirmoi mbështetjen e plotë për dy mesfushorët. “Bajrami nuk po kalon momentin e tij më të mirë, ndërsa Muçi ka pasur një dëmtim të lehtë, por tashmë është rikuperuar dhe ka luajtur 45 minuta me klubin. Të dy janë shumë të rëndësishëm për Kombëtaren dhe gjithmonë japin maksimumin në fushë”. Braziliani pranoi se ka pasur dilema gjatë përgatitjes së listës, por theksoi se eksperiencia është vendimtare në ndeshje të tilla. “Puna për listën nis herët, që në fillim të gushtit. Këto janë ndeshje ku duhen lojtarë që kanë eksperiencë dhe janë mësuar me stilin tonë të lojës. Sigurisht,

momenti i lojtarëve të rinj do të vijë, por jo tani”, ka deklaruar strategu brazilian. Sylvinho përmendi edhe disa futbollistë të Superiores që po ndiqen nga stafi teknik, si Qefalija dhe Dajsinani, duke lënë të hapur mundësinë që ata të jenë pjesë e Kombëtares në të ardhmen. “Qefalija është një lojtar teknik dhe inteligjent, por për shkak të një dëmtimi dhe pas një diskutimi me klubin, nuk u grumbullua. Po ashtu, po vlerësojmë edhe lojtarë nga Egnatia, Tirana, Dinamo dhe Partizani. Dajsinani është një portier me personalitet dhe shpejtësi, dhe këto janë elemente që i vlerësojmë”, ka përfunduar Sylvinho.

LISTA E FUTBOLLISTËVE:

Portierë: Thomas Strakosha, Elhan Kastrati, Mario Dajsinani.

Mbrojtës: Elseid Hysaj, Ivan Balliu, Mario Mitaj, Naser Aliji, Marash Kumbulla, Adrian Bajrami, Berat Gjimeshi, Arlind Ajeti.

Mesfushorë: Ylber Ramadani, Julian Shehu, Kristjan Asllani, Medon Berisha, Qazim Laçi, Adrien Pajaziti, Nedim Bajrami, Arbër Hoxha, Ernest Muçi, Jasir Asani.

Sulmues: Armando Broja, Myrto Uzuni, Rey Manaj, Mirlind Daku.

Tefik Osmani emërohet drejtor i ri i departamentit të skautizmit në FShF

TIRANË, 29 GUSHT - Tefik Osmani është emëruar drejtor i ri i departamentit të skautizmit në FSHF. Ai ka pasur një karrierë të gjatë dhe të rëndësishme si futbollist, duke qenë pjesë e klubeve të njohura si Skënderbeu, Tomori, Partizani, Elbasani, Tirana, Teuta, Vllaznia dhe Metalurg Zaporizhja në Ukrainë. Osmani qenë gjithashtu pjesë e kombëtares shqiptare. Pas përfundimit të karrierës si lojtar, Osmani ka ushtruar me sukses detyrën e drejtorit sportiv te Tirana dhe Vllaznia. Në rolin e ri



në FSHF, ai do të angazhohet në procesin e identifikimit dhe ndjekjes së talenteve shqiptare, si brenda vendit, ashtu edhe jashtë tij, me qëllim përfshirjen e tyre në ekipet kombëtare të moshave dhe

ato përfaqësuese. Ky rol është mbajtur më parë me profesionalizëm dhe kompetencë të lartë nga Ardi Behari, i cili do të vijojë karrierën e tij në departamentin e edukimit në FSHF, ku do të merret me organizimin e kurseve për trajnerët dhe zhvillimin e programeve edukative. Drejtoria Teknike e FSHF-së shpreh vlerësimin e saj për punën e palodhur të bërë nga Behari në departamentin e skautizmit dhe për kontributin e çmuar gjatë kësaj periudhe.

SHKURT

Zvicra pas Jasharin ndaj Kosovës dhe Sllovenisë

Mesfushori i Milanit, Ardon Jashari, nuk do të marrë pjesë në grumbullimin e Kombëtares së Zvicrës për ndeshjet e ardhshme ndaj Kosovës dhe Sllovenisë. Lajmin e konfirmoi Federata Zvicerane, duke bërë të ditur se Jashari ka pësuar një frakturë në kaviljen e djathtë. Trajneri i Kombëtares së Zvicrës do të duhet të bëjë ndryshime në listën e lojtarëve për të plotësuar mungesën e Jasharit. Mesfushori pësoi lëndim në stërvitje, në startin e tij të sezonit me klubin e ri, Milan, dhe pritet të mungojë rreth 2 muaj.

Tony Parker: Shpresoj që një ditë të bëhem trajner në NBA

Tony Parker është një legjendë e basketbollit evropian dhe një ikonë e San Antonio Spurs dhe NBA. Në një intervistë për “L’Equipe”, Parker ka dhënë një intervistë, duke zbuluar ëndrrën e tij. Ai ka rrëfyer se ëndrra e tij është të jetë trajner në NBA, për të vijuar edhe më tej aventurën e tij aty ku dhe u bë i famshëm si lojtar. Tashmë 43-vjeçar, ai pret të marrë certifikatën e nevojshme për të provuar këtë aventurë. “E njoh mirë NBA, pasi kam luajtur aty për një kohë shumë të gjatë. Të shohim se çfarë do të rezervojë e ardhmja, por do të më pëlqente të isha trajner në NBA një ditë”, ka deklaruar Parker, që ka fituar 4 tituj kampionë me Spurs.

Hamilton: Do të përpiqemi ta shijojmë këtë gjysmë të dytë të sezonit dhe të fitojmë

Botërori i Formula 1 rikthehet këtë fundjavë me garën e Cmimit të Madh të Holandës, që zhvillohet në pistën e Zandvoort. Te Ferrari presin një “rizgjim” në këtë pjesë të dytë të sezonit, ashtu sikurse ndodhi edhe vjet. Lewis Hamilton, duke folur për garën e radhës dhe pushimet 3-javore, ka thënë: “Kam pushuar gjatë verës dhe ndihem plot energji. Kjo gjysmë e parë e sezonit, e cila nuk ka qenë më e këndshme, ka qenë me shumë presion mbi ne”. “Tani duhet të kujtojmë pasionin që kemi për punën tonë dhe se të gjithë jemi pjesë e të njëjtit projekt. Do të përpiqem ta shijoj veten dhe këtë fundjavë”, ka shtuar 7 herë kampioni i botës. Hamilton foli edhe për përditësimet e bëra në SF-25 gjatë sezonit: “Jemi në rrugën e duhur. Me përditësimet e reja, kemi përmirësuar konfigurimin. Po nxjerrim gradualisht më shumë potencial nga makina jonë dhe shpresojmë të jemi në gjendje ta bëjmë këtë përsëri këtë fundjavë. Kemi disa objektiva dhe shpresojmë që t’i arrijmë sa më shpejt”.

Messi paralajmëron lamtumirën nga Argjentina: Mund të jetë ndeshja e fundit në shtëpi

Lionel Messi pritet të luajë ndeshjen e tij të fundit në shtëpi me kombëtaren argjentinase. Kampionët në fuqi të botës do të përballen me Venezuelën më 4 shtator, në stadiumin Monumental të Buenos Airesit, në kuadër të kualifikuesve për Botërorin

2026. Tetë herë fituesi i Topit të Artë foli për një lamtumirë të mundshme para tifozëve argjentinase pas kualifikimit të Inter Miami në finalen e Kupës së Ligave. “Do të jetë një ndeshje shumë e veçantë për mua, sepse është e fundit në shtëpi në fazën

kualifikuese. Nuk e di nëse do të kemi ndeshje miqësore më vonë, por e gjithë familja ime do të jetë e pranishme. Do ta përjetojmë si një lamtumirë në shtëpi, nuk e di çfarë do të vijë më pas”, ka thënë Messi pas gjysmëfinales kundër Orlando Cityt. Federata

Argjentinase e Futbollit po shfrytëzon maksimalisht këtë moment: biletat më të lira për duelin me Venezuelën kushtojnë rreth 85 euro, ndërsa për vendet më të mira çmimi arrin deri në 430 euro. Argjentina e siguroi kualifikimin për Botëror që

në muajin mars, pas fitores ndaj Brazilit. Skuadra e Lionel Scalonit do ta mbyllë fushatën më 9 shtator në Ekuador. Botërori i vitit të ardhshëm mund të shënojë edhe ndeshjet e fundit të Messit me fanellën e “Albiceleste”.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Blerta Deva” B.I. - D.P.T. “Calypso” me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811134923 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti “Blerta Deva” B.I. - D.P.T. “Calypso” Jakovica donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811134923 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that “Blerta Deva” B.I. - D.P.T. “Calypso” with headquarters Gjakovë, has come to the decision to quit its business: 811134923 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Esnak Mejzini shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Ermal Ademaj B.I. shpall të pavlefshme numrin e biznesit me nr. 810003129 të lëshau nga M.T.I.

- BESNIK Polloshka shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Dijane Kërleshi shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Burim Buza shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1904

Columbus, Georgia, USA
0.5L

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

